

Procesverbal

*Nga Mbledhja I (e parë) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Dragashit, e mbajtur më datë:
22.12.2025*

Usmen Baldzi: Të nderuar delegatë, përshëndetje të gjithëve, mirë se vini në seancën e parë të rregullt të Kuvendit të Komunës së Dragashit. Për këtë seancë, në mënyrë të rregullt dhe me kohë, kemi pranuar rendin e ditës, i cili përmban pikat vijuese të rendit të ditës:

1. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
2. Themelimi i Komitetit për Politikë dhe Financa,
3. Themelimi i Komitetit për Komunitete,
4. Zgjedhja e Nënkryetarit për komunitete të Komunës së Dragashit,
5. Propozim Vendim për shpalljen e listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronës së paluajtshme të Komunës,
6. Eventuale.

Nëse ndonjëri nga delegatët e pranishëm dëshiron ose ka vullnet që lidhur me rendin e ditës të thotë diçka, të shtojë apo të propozojë, urdhëroni, keni fjalën. Meqë nuk ka, e vë në votim rendin e ditës. Kush është pro, kundër, abstenim. Konstatohet se nga 21 delegatë të pranishëm: 21 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Të nderuar delegatë, në pikën e parë të rendit të ditës kemi obligim të zgjedhim Kryesuesin e Kuvendit të Komunës së Dragashit. Për këtë arsye, në bazë të Ligjit në fuqi për Vetëqeverisje Lokale dhe akteve nënligjore, ftoj partitë politike që të propozojnë kandidatët e tyre, përkatësisht kandidatin e tyre për Kryesues të Kuvendit të Komunës së Dragashit. Prandaj, së pari, ftoj partinë më të madhe politike LDK, respektivisht Lidhjen Demokratike të Kosovës, që të propozojë kandidatin e saj. Urdhëroni.

Arijeta Skeraj: Faleminderit për fjalën! Përshëndetje për të gjithë! Nga Grupi Parlamentar i LDK-së propozojmë Resul Fetahun që të jetë kandidat për kryesues. Resul Fetahu është i lindur më 1985 në fshatin Kuk, ku e kreu edhe shkollën fillore. Të mesmen e kreu në Prizren, ndërsa Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike Universitetin e Prishtinës, drejtimin e Komunikacionit Rrugor. Studimet

master i vijon në Kolegjin Tempulli në Prishtinë, drejtimi i Komunikacionit Rrugor. Pas përfundimit të studimeve, karrierën profesionale e ka vazhduar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Planifikimit Hapësinor, në Departamentin për Menaxhimin e Rrugëve. Më pas ka vazhduar si kandidat për asambleist, ku në vitin 2021 ka qenë një ndër kandidatët më të votuar në Komunën e Dragashit, gjë që e ktheu edhe LDK-në në Komunë. Resul Fetahu është i martuar, baba i tri vajzave dhe një djali. Andaj, ju ftoj që ta mbështesim kandidaturën e këtij profesionisti, pasi që jam i sigurt që i njëjti do ta udhëheq Asamblenë në mënyrë të shkëlqyer. Faleminderit!

Granit Rifaj: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Ju uroj për mandatin! PDK-ja nuk ka kandidat!

Uran Halimi: Përshëndetje për të gjithë! Urime për mandatin e ri! Ne si Grup i LVV-së nuk kemi kandidat! Faleminderit shumë!

Usmen Baldzi: Konstatoj se LDK-ja, me zotërinë e propozuar, është e vetmja parti që propozon Kryesues të këtij Kuvendi. Prandaj, të nderuar delegatë, në përputhje të plotë me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, që zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Dragashit të kalojë në formën e paraparë ligjore, duhet të formojmë një komision prej tre anëtarësh që do të merret me udhëheqjen e procesit të votimit dhe në bazë të tij të zgjidhet Kryesuesi i Kuvendit. Prandaj ftoj dy partitë më të mëdha politike të propozojnë emrat e tyre, po ashtu ftoj edhe partinë nga komunitetet joshumicë. Ftoj LDK-në që të propozojë anëtarin e komisionit për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Arijeta Skeraj: Ne si LDK propozojmë Samidin Xheladinin si anëtar të Komisionit!

Granit Rifaj: Në emër të PDK-së propozojmë Suada Bajramin!

Ventaza Esati: Nga JGP propozojmë Danis Hodza!

Usmen Baldzi: Në bazë të tre kandidatëve të propozuar, ftoj Kuvendin të shprehet. Meqë e miratuar komisionin, ftoj komisionin të përgatisë fletëvotimet. Delegatët të presin përgatitjet. Ftoj komisionin të vazhdojë me punën.

Samidin Xheladini: Të nderuar të pranishëm, ju përshtendes të gjithëve! Po fillojmë me procesin e votimit për kryesuesin Asamblesë Komunale. Votimi do të bëhet në mënyrë të fshehtë. Për shkak të kushteve më ideale për votim, e kemi paraparë që votimi të bëhet në zyrën e përkthyesit. Ju faleminderit! Po fillojmë me procesin e votimit!

(Pas votimit...)

Konstatojmë se votimi i krye me sukses. Tash fillojmë me numërimin!

(Pas numërimit...)

Të nderuar delegatë dhe të pranishëm! Nga të gjithë 21 delegatët, të gjithë kanë votuar. Nga votimi del se: 12 vota janë PRO që Resul Sinani të zgjidhet kryesues, 5 vota janë KUNDËR, 2 janë ABSTENIM dhe 2 Të PAVLEFSHME. E urojmë Resul Fetahun për zgjedhjen e tij kryesues!

Usmen Baldzi: Faleminderit. Në emrin tim personal dhe në emër të delegatëve të pranishëm, e uroj Kryesuesin e zgjedhur të Kuvendit, i cili ka fituar shumicën e votave. Në emrin tim personal ju falënderoj të gjithëve, në cilësinë e anëtarit më të moshuar të Kuvendit të Komunës së Dragashit, për udhëheqjen e deritanishme, bashkëpunimin dhe kooperimin tuaj për t'i dhënë kësaj seance hapat e parë pozitivë. Për vazhdim ju uroj shëndet të mirë, marrëdhënie demokratike mes nesh dhe bashkëpunim pozitiv, me qëllim që Komuna e Dragashit të ketë një Kuvend të përfaqësuar denjësisht jo vetëm në Dragash, por edhe në rajon e më gjerë. Ju lus që fryma e tolerancës të vazhdojë dhe besoj se pasardhësi im në këtë karrige do të jetë po aq pozitiv, që të kemi një Kuvend të mirë dhe cilësor në frymë demokratike dhe shkëmbim mendimesh. Ftoj Resul Fetahun të zërë vendin e tij. Faleminderit.

Resul Fetahu: I nderuar kryetar i Komunës, z.Bexhet Xheladini, e nderuar ish-kryesuese e Asamblesë Komunale, znj.Arijeta Skeraj, të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës, të nderuar zyrtarë komunalë, përfaqësues të mediave, OSBE, zonja dhe zotërinj! Ju falënderoj sinqerisht dhe me përlulësi për besimin që ma dhatë me votën tuaj për të ushtruar funksionin e kryesuesit të Kuvendit të Komunës. Ky besim për mua përfaqëson një nder të veçantë, por njëkohësisht edhe një përgjegjësi të madhe institucionale dhe morale. Me këtë rast, dua të shpreh edhe mirënjohjen time të thellë për qytetarët dhe votuesit e Komunës

sonë të cilët, përmes votës së lirë dhe demokratike, na kanë dhënë mandatin për të përfaqësuar interesat e tyre. Besimi i qytetarëve është themeli i legjitimitetit institucional dhe udhërrëfyesi kryesor i punës sonë të përditshme. Jam plotësisht i vetëdijshëm për rëndësinë e këtij funksioni dhe për pritjet që qytetarët kanë nga ne si përfaqësues të tyre legjitimë. Prandaj, ju siguroj se këtë detyrë do ta ushtroj me përkushtim maksimal, profesionalizëm dhe paanshmëri të plotë, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjet në fuqi dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës. Si kryesues i Kuvendit, do të angazhohem që puna e Kuvendit të zhvillohet në mënyrë transparente, të rregullt dhe gjithëpërfshirëse, duke garantuar barazi në trajtim dhe respekt të ndërsjellë për të gjithë anëtarët e Kuvendit, pa asnjë dallim. Do të inkurajoj dialogun konstruktiv, debatin demokratik dhe bashkëpunimin institucional, si elemente thelbësore për marrjen e vendimeve të drejta dhe në interes të qytetarëve tanë. Jam i bindur se vetëm përmes bashkëpunimit, dialogut të hapur dhe respektit reciprok, do të arrijmë t'i përmbushim me sukses obligimet tona ndaj qytetarëve që na kanë besuar këtë mandat. Përgjegjësia jonë e përbashkët është që, vendimet që marrim në këtë Kuvend, të reflektojnë interesin publik dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Komunës sonë. Në fund, ju falënderoj edhe një herë për besimin dhe mbështetjen e dhënë! Falënderoj qytetarët për votën dhe besimin e tyre, dhe ju uroj punë të mbarë, suksese, bashkëpunim të frytshëm të të gjithëve në ushtrimin e këtij mandati. Ju faleminderit!

Të nderuar anëtarë të Kuvendit, në bazë të Nenit 54 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore, përkatësisht, së paku 10% e qytetarëve i përkasin komunitetit joshumicë - andaj, posti i zëvendëskryesuesit të Kuvendit për komunitete është i rezervuar për përfaqësuesit e këtyre komuniteteve. Në bazë të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve dhe listës së hapur të kandidatëve, konstatoj se kandidati përfaqësues i komuniteteve joshumicë që ka marrë numrin më të madh të votave, është z.Danis Hodza. Rrjedhimisht, në përputhje me Nenin 54 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, konstatoj se posti i zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për komunitete i takon z.Danis Hodza. Ftoj z.Danis Hodza që të ulet në ulësen e zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Të nderuar delegatë, në vijim të kësaj seance dhe me rendin e ditës të miratuar, do të procedojmë me shqyrtimin e pikave të tjera, përkatësisht me zgjedhjen e komiteteve obligative të Kuvendit, duke filluar me Komitetin për Politikë dhe Financa, si organ me rëndësi të veçantë për funksionimin e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e çështjeve financiare dhe politike të Komunës. Ju ftoj

për bashkëpunim konstruktiv në këtë proces, në mënyrë të vendimmarrja të zhvillohet në mënyrë institucionale dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Të nderuar delegatë, ftoj partitë që të propozojnë emrat për anëtarët e KPF-së!

Samidin Xheladini: Në emër të LDK-së, propozoj Xhyllferie Bahtijari Beqiri dhe Marigona Berisha Latifi. Për në KPF!

Granit Rifaj: Në emër të PDK-së, propozojmë z.Artan Loshaj dhe znj.Suada Bajrami!

Jetmir Ajdini: Përshëndetje për të gjithë! Urime për pozitën, z.Resul! Nga Vetëvendosje propozojmë Uran Halimin!

Ventaza Esati: Nga JGP propozojmë z.Danis Hodza!

Resul Fetahu: Të nderuar delegatë, ashtu siç e dini, kryesuesi i Kuvendit me automatizëm është edhe anëtar i KPF-së dhe kryesues i këtij Komiteti. Do t'i lexoj edhe një herë emrat: do të jem unë Resul Fetahu, Xhyllferie Bahtijari, Marigona Berisha Latifi, Artan Loshaj, Suada Bajrami, Uran Halimi dhe Danis Hodza. Atëherë, e hedhim në votim! Kush është pro themelimit të KPF-së me këta anëtarë? A ka kundër? Abstenim? Konstatojmë e me 21 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën tjetër, për zgjedhjen e Komitetit për Komunitete. Ftoj nga JGP që ta propozojnë një përfaqësues!

Danis Hodza: Nga JGP propozojmë znj.Ventaza Esati!

Behar Brenoli: Nga SDU Behar Brenoli!

Usmen Baldzi: Nga VAKAT Usmen Baldzi!

Xhyllferie Bahtijari Beqiri: Nga LDK e propozojmë Samidin Xheladinin!

Granit Rifaj: Në emër të PDK-së propozojmë z.Pajtesa Piraj të jetë anëtare e Komitetit. Por, e kemi një kërkesë, një sqarim prej jush, ose nga dikush prej ekzekutivit. A mundet me u rrit Komiteti për Komunitete me shtatë anëtarë? Besoj se është më mirë për komplet anëtarët e Kuvendit? Faleminderit!

Uran Halimi: Kërkesën që e bëri Graniti, unë e falënderoj, të njëjtën kërkesë e kemi edhe ne, meqenëse ligji nuk na e kushtëzon numrin e anëtarëve dhe ne si subjekt i LVV-së jemi subjekti i tretë në Kuvend. Po besoj që e meritojmë ta kemi edhe na një përfaqësues në Komitet për Komunitete. Andaj, kisha kërkuar nga ju, kryesues dhe ju si ekzekutiv, që le të zgjerohet ose le të rritet numri, ta kemi edhe ne një anëtar në Komitet për Komunitete. Nuk është e thënë që anëtarët e Komitetit për Komunitete patjetër me qenë edhe delegatë të Kuvendit. Subjektet politike kanë të drejtë me propozue edhe njerëz jashtë Kuvendit, mundemi me e zgjerue numrin nga pesë në shtatë. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Sa i përket kërkesës që e bëri Grupi i PDK-së dhe LVV-së, unë dua të ju sqaroj se, në bazë të Rregullores dhe ligjit, Komiteti për Komunitete duhet ta ketë shumicën nga komuniteti joshumicë. Kështu që, duke marrë parasysh se komuniteti joshumicë në këtë Komitet i ka tre asambleistë, atëherë kemi qenë të detyruar që numri i anëtarëve të Komitetit për Komunitete të jetë pesë. Për këtë kemi rënë dakord edhe me partitë politike që përfaqësojnë komunitetin joshumicë kërtu, që ky numër nuk mund të shtohet mbi pesë, edhe pse ekziston kërkesa dhe dëshira që të shtohet. Komiteti për Komunitete është komitet i cili i mbron interesat e komunitetit joshumicë, andaj edhe i kemi zyrtarisht këto dy komitete në Komunën e Dragashit. Kështu që, për këtë arsye ky numër. Kërkesa është ndoshta edhe e arsyeshme, por nuk do të rritet, do të jetë pesë. Faleminderit!

Uran Halimi: I nderum kryetar, unë jo rastësisht e thashë që anëtarët e Komitetit për Komunitete kanë të drejtë të jenë qytetarë që nuk janë delegatë të Kuvendit. Edhe subjektet politike që janë këtu, të komuniteteve, kanë të drejtë me propozue ma shumë anëtarë, nuk është patjetër që me qenë delegatë të Kuvendit. Ta zëmë shembull, JGP munden me pas dy ose tre, në bazë të numrit, mundemi me e rrit numrin edhe te komuniteteve, që neve me na mundësue me e pas edhe një vend në Komitetin për Komunitete. Kjo është në favor edhe të subjekteve politike të komuniteteve, nuk është që na bëhet neve nder ose favor. Rritet numri i përfaqësuesve edhe të komuniteteve, edhe neve na mundësohet që me e pas një delegat në Komitetin për Komunitete. I nderum kryesues, mundesh me e rrit nëse ekziston vullneti, ju mundeni me e rrit numrin e anëtarëve të Komitetit për Komunitete. Në Komitet për Komunitete, anëtarët kanë të drejtë me qenë edhe jashtë Kuvendit. Faleminderit!

Resul Fetahu: Atëherë, kanë të drejtë më shumë ndoshta, mirëpo nuk kemi komunitete tjera përveç këtyre që janë të përfaqësuara në Kuvend.

Usmen Baldzi: Nëse procedurat ligjore dhe ligji na lejojnë, dhe nëse kemi mundësi buxhetore e financiare, edhe pse kjo është pasqyrë e Kuvendit, dhe nëse është në funksion të bashkëpunimit të mirë, atëherë JGP-ja le të gjejë mundësi të shtojë një anëtar nga shoqëria civile ose jashtë Kuvendit. Kështu nuk do të kishte problem. Këtë e propozoj për të krijuar klimë pozitive në Kuvend, që anëtarët e VV-së të mos ndihen të anashkaluar. Është e qartë se ky komision duhet të ketë shumicë nga komunitetet joshumicë, por nëse ka mundësi edhe buxhetore, pse jo? Nuk duhet të zvarritemi; mund të bëhet edhe një pauzë, që përfaqësuesi i VV-së dhe kryetari të gjejnë një zgjidhje. Nëse është e mundur, mirë; nëse jo, të jemi të qartë që të mos kemi polemika për një çështje, sipas mendimit tim, të lehtë.

Granit Rifaj: Shkurt, nuk po e zgjati, vetëm me u sqarue. Mundësitë ligjore ekzistojnë. E thanë edhe kolegët paraprakë. Kryetari e dha një propozim të mirë, një pauzë pesë minuta, mundemi me e diskutue bashkë edhe, në qoftë se ka vullnet politik, kjo kryhet, në qoftë se nuk ka, ju i keni votat, i grahish me t'juajën!

Resul Fetahu: Atëherë, marrim pak pauzë! Ftoj nga një përfaqësues për një sqarim në zyrën e kryetarit!

Atëherë, pas konsultimit me të gjitha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, i heshim në votim këta emra: Ventaza Esati, Behar Brenoli, Usmen Baldzi, Samidin Xheladini dhe Pajtesa Piraj. Komuniteti joshumicë nuk po dëshirojnë me e rrit numrin.

Danis Hodza: Përshëndetje të gjithëve, siç e theksova pak më herët në takim, ne jemi të përfaqësuar në këtë Komitet dhe kjo është arsyeja pse nuk dëshirojmë të rritet numri.

Resul Fetahu: Faleminderit! Nuk ka diskutime jera! E hedhim në votim! Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Konstatojmë se me 18 vota pro, 3 kundër dhe zero abstenim, kalon edhe kjo pikë. Vazhdojmë me pikën tjetër: zgjedhja e nënkryetarit për Komunitete të Komunës së Dragashit. Ftoj kryetarin që ta marrë fjalën!

Bexhet Xheladini: Të nderuar të pranishëm, në bazë të kompetencave të mia si kryetar i Komunës, për nënkryetar të komunitetit joshumicë propozoj nënkryetarin e deritanishëm, z.Fejzal Halilovic. Ai është tashmë i njohur për opinionin publik, për ju asambleistët dhe për komunitetet që jetojnë në Komunën e Dragashit, nuk ka nevojë t'ua lexoj biografinë. Gjatë punës së tij katërvjeçare, ai ka qenë një person i cili vazhdimisht ka punue në të mirën e qytetarëve të Dragashit dhe komunitetit joshumicë. Gjithashtu, ka pas një bashkëpunim të mirë edhe me Asamblenë Komunale, edhe me kryetarin e Komunës. Kështu që, unë propozoj që z.Fejzal Halilovic të jetë kandidat për nënkryetar të komunitetit joshumicë. Faleminderit!

Usmen Baldzi: Keni një lëshim të vogël. Duke qenë se ju, si kryetar i Komunës së Dragashit, po propozoni nënkryetarin, propozimi juaj duhej të ishte në përputhje, me marrëveshje ose pas konsultimit me komunitetet joshumicë. Ju këtë nuk e keni bërë; të paktën mua personalisht askush nuk më ka thirrur dhe askush nuk ka biseduar me mua, ndërsa e dimë se në Dragash ka dy komunitete joshumicë, gorane dhe boshnjake, dhe konsultimi duhej të bëhej me të dyja palët. Ndoshta keni llogaritur në ndonjë numër në Kuvend, kjo është çështja juaj; unë, si anëtar i këtij Kuvendi, kërkoj që të bëni konsultime paraprake dhe pastaj ta sillni propozimin për miratim.

Resul Fetahu: Faleminderit! Atëherë, vazhdojmë me votimin. Një herë do të votojë komuniteti joshumicë për nënkryetarin për komunitete, e pastaj të gjithë delegatët e Kuvendit. Nga radhët e komuniteteve, kush është pro? Kush është kundër? Abstenim? Konstatojmë se e 3 vota për, 1 kundër dhe zero abstenim, miratohet kjo pikë nga komuniteti joshumicë. Atëherë, e hedhim në votim edhe nga të gjithë delegatët e Kuvendit. Kush është pro? Kush është kundër? Abstenim? Konstatojmë se me 17 vota pro, 4 kundër dhe zero abstenim, zgjidhet nënkryetari për Komunitete, Fejzal Halilovic. Urime!

Fejzal Halilovic: I nderuar kryesues, delegatë të Kuvendit, OSBE, media dhe të gjithë të pranishmit. Më lejoni t'ju përshëndes në emër të komuniteteve joshumicë që përfaqësoj dhe në emrin tim personal, si dhe të shpreh falënderimin tim të thellë kryetarit të Komunës së Dragashit dhe delegatëve që sot më besuan duke më zgjedhur Nënkryetar të Komunës nga radhët e komuniteteve joshumicë. Para jush premtoj se do t'i kryej me nder, ndershmëri dhe përgjegjësi të gjitha detyrat në fushëveprimin e nënkryetarit për komunitete të Komunës së Dragashit. Faleminderit.

Resul Fetahu: Faleminderit! Atëherë, vazhdojmë me pikën tjetër: Propozimvendimi për shpalljen e Listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronës së paluajtshme të Komunës.

Qamil Kolloni: Përshëndetje për të gjithë! Në bazë të Nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nenit 13 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komunale, si drejtori jemi të obliguar që para datës 31 dhjetor t'i bëjmë publike në uebfaqen e Komunës, gjithashtu pas miratimit në këtë seancë. Besoj se e keni lexue edhe materialin të cilin e keni. Ju ftoj që ta votoni, që të kemi mundësi që për vitin tjetër t'i japim në shfrytëzim pronat të cilat janë të parapara. Faleminderit!

Artan Loshaj: Përshëndetje për të gjithë! Pasi po diskutojmë për këtë pikë të rendit të ditës, unë edhe si asambleist i legjislaturës së kaluar, jam për që të votohet kjo dhe të qitet në faqen zyrtare. Por, e kam një kërkesë prej drejtorit, që mundësisht të mos na bjer copy-paste si viteve të kaluara. Por, janë disa parcela këtu, për shembull, që nuk kanë numër të parcelës, në disa tjera nuk është edhe metri katror. Kështu që, pasi ta votojmë këtë, le ta bëjë një përmirësim, ose le t'i matin këto edhe le t'i shkrujnë sa metër katrorë ka parcela, ose, qajo parcelë që s'ka numër të parcelës, e ka veç metrin katror. Le ta bëjë një korrigjim këtu, se i njëjti është i vitit të kaluar, i njëjti është i këtij viti. Për shembull, te Lista e pronave të përgjithshme, në numrin rendor 18, numri i parcelës nuk ekziston, ndërsa është vetëm 6 metër katrorë, në Dragash - duhet me e ditë ku është. Shkojmë më poshtë, numër 36, e ke pa numër të parcelës, zero metër katror, kjo me siguri duhet me u largue krejt. Shkojmë më poshtë, numër 82, numër 64, nuk ka numër të parcelës. Numër 110 nuk ka numër të parcelës, nuk ka edhe metër katror. Shkojmë më poshtë, 146, 147, 148, njëjtë, nuk kanë numër të parcelës, nuk kanë metër katror. Edhe te Lista e veçantë është e njëjta. Edhe një herë kërkoj nga drejtori që ta bëjë përmirësimin e kësaj, edhe unë jam për me e votue këtë, veç me përmirësime.

Qamil Kolloni: E falënderoj paraprakisht delegatin. Janë numra në kontest gjyqësor, të cilët nuk janë qit. Në momentin kur të merren vendimet gjyqësore, plotësohen edhe ato, i shtohet edhe numri edhe metri katror, edhe bëhen publike. me rëndësi është që Komuna shpreh interesimin që t'i ketë këto të miratuara. Në çfarëdo rasti që ndodh, për shembull, kemi pas vitin e kaluar - ju jen delegat i vjetër - e kemi pas rastin, edhe kur na është shpreh interesi publik që me e dhënë brenda vitit, nuk e kemi pas të evidentuar këtu, edhe na janë shkaktuar probleme procedurale, u dashtë edhe një vit tjetër me prit. Investitorët nuk kanë kohë me na prit neve. Për këtë arsye, edhe me konteste

gjyqësore i kemi lejue këtu që t'i kemi. Në momentin kur të marrim vendimin gjyqësor, ne i plotësojmë me numrat përkatës. Besoj që në aspektin teknik nuk paraqet problem për ne, por derisa janë në kontest gjyqësor, nuk kemi të drejtë ta bëjmë. Kështu që, besoj nuk shkaktojnë ndonjë vështirësi.

Usmen Baldzi: I nderuar kryesues, duket sikur nuk më keni dëgjuar kur ju urova dhe kërkova tolerancë. Mendoj se menjëherë po ndëshkohet ai që kërkoi tolerancë. Mendoni, nuk është kështu dhe nuk është mirë; nuk është frymë e mirë. Kryetar, unë kam të drejtë dhe do t'i ankojem ministrisë për emërimin e parregullt të Nënkryetarit. Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, në të gjitha kuvendet e botës, edhe në tonin, është rregull që kur kemi një pikë rendi dite, janë deputetët ata që diskutojnë, polemizojnë, madje edhe debatojnë; drejtori ulet dhe pret në fund. Nuk mund të shkëmbejmë fjalë për fjalë me drejtorin. Çdo drejtor, edhe në të ardhmen, duhet të presë të gjitha fjalimet e këshilltarëve dhe pastaj të kërkojë fjalën. Unë, si anëtar i ri i Kuvendit, nëse drejtori ka menduar se i di përmendësh të gjitha parcelat dhe të votoj, nuk ka të drejtë. Nëse është obligim ligjor, do të votojmë. Askush nuk është kundër funksionimit normal të Kuvendit dhe Komunës. Por këtu njeriu nuk mund të shohë qartë se çfarë po jep. Të votohet kështu, “blanko”, nuk është në rregull. Propozuesi, drejtori Qamil, duhej të sillte edhe emërtimin. Shkruan shumë gjëra; Artani ka të drejtë, nuk ka numër parcele, madje as emër. Si ta dimë çfarë po japim e çfarë po mbajmë? Kjo duhej përgatitur më mirë. Nëse ligji e kërkon, do të votojmë; nuk jemi kundër ligjit, jemi betuar në emër të ligjit. Por ju lutem, bëjini gjërat siç duhet kur vini para nesh; ne jemi të zgjedhur nga populli, ju jeni nga kryetari.

Qamil Kolloni: Usmen, këta delegatët të cilët kanë qenë këtu në vazhdimësi, për herë të parë kjo ka ndodhë në vitin 2022, pasi e kemi marrë na pushtetin. Janë kërkesa edhe të dhëna të cilat janë të parapara me ligj. I kemi qit kolonat dhe numrat, ti tash e dish që përmes atij numri, përmes Gjeoportalit, mund ta gjesh secilin vend. Lokacioni të tregon, dihet cila është zona kadastrale, në bazë të numrit mundesh me i gjet të gjitha të dhënat, dhe këto vlejnë për njerëz të cilët kanë interes që t'i marrin këto. Nuk mund të japim të dhëna tjera, por besoj që prej qatij numrit mund t'i marrish të gjitha të dhënat, në qoftë se je i interesuar. Ne kemi treguar edhe herave tjera, që prej Ministrisë

kërkohen këto të dhëna dhe në vazhdimësi, për katër vite, kështu miratohen këto lista dhe bëhen publike në uebfaqen e Komunës.

Usmen Baldzi: I nderuar drejtor, unë nuk shpreha dyshim. Do të votojmë për gjithçka që është; kjo u tha edhe nga përfaqësuesi i PDK-së. Do të votojmë, sepse është obligim ligjor. Por ju duhet... Ja, çfarë dua të them: nuk më kuptuat. Numri rendor, numri i dosjes, një, dy, tre, prapë është numër rendor sipas numrave kadastralë. Numri i parcelës, emri. Shtoni vetëm emrin. Ne, si anëtarë të Kuvendit, nuk jemi grup interesi për të kërkuar numra parcelash për të konkurruar nesër për atë vend. Ne marrim material nga propozuesi dhe organet e Kuvendit dhe kaq. Mund ta kërkojmë në geoportal ku është e çfarë është. P.sh., këtu ka në Brod; ka një numër, por nuk e dimë çfarë po japim. Askush nuk e di. Nuk po kërkoj shumë; nëse është e vështirë për ju ta bëni, kjo është tjetër gjë. Vetëm shtoni emërtimin e parcelës.

Granit Rifaj: S'po due me e zgjat shumë. Parafolësi e pat shumë mirë propozimin që e dha, edhe drejtori kallxoi që në seancat e kalume, kur i kemi miratue, e kemi pas veç të njëjtin problem. Obligimet që janë ligjore, i mbështesim. Ama këtu, edhe prej Kuvendit të kaluar ka pas këso. Unë në qoftë se shkoj personalisht, unë këtu nuk i kqyri me numër të parcelës. Thashë edhe më herët, në qoftë se keni vullnet - votat i keni, edhe mundeni veç me e qit në votim, mos me na lënë me folë - por në qoftë se ka vullnet politik, këto munden me u bo. Çka me thënë unë nesër para qytetarëve, çka kam votue? Secilës me i shkue me numër të parcelës, po thuesh? Të lutem, në qoftë se ke mundësi ligjore, më mirë me i pru, më të sqarume, bare me emërtime. Faleminderit!

Resul Fetahu: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Nëse nuk ka, atëherë e qesim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Konstatojmë se me 14 vota pro, zero kundër dhe tri abstenime, miratohet kjo pikë e rendit të ditës. Atëherë, kalojmë në pikën eventuale. A do dikush me e marrë fjalën në këtë pikë?

Usmen Baldzi: Meqë nuk më dhatë fjalën gjatë pikës së rendit të ditës për votimin e Nënkryetarit, të sqarojmë disa gjëra. Unë vetëm kërkova nga kryesuesi të bëjë pauzë, por nuk gjeta mirëkuptim për konsultim me komunitetet joshumicë. Këtu kemi tre subjekte politike nga dy komunitete joshumicë. Duke qenë se balanca politike në Kuvend është 2–2 dhe se udhëzimi administrativ për

votim dhe përcaktim të vendit nuk parashikon nëse është nga komuniteti goran apo boshnjak, kryetari duhej t'i thërriste të katërtit; ashtu siç më ka thirrur mua si anëtarin më të moshuar, mund të më konsultonte nëse pajtohem për emrin e propozuar. Emri i propozuar—të mos keqkuptohet personalisht—por politikisht, duke qenë se nuk u konsultova, kështu ishte edhe vota ime.

Bexhet Xheladini: Të nderuar të pranishëm, bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutin e Komunës, pozita e nënkryetarit të komunitetit joshumicë i takon komunitetit shumicë në kuadër të komunitetit joshumicë. Komunitet shumicë janë goranët dhe Fejsal Halilovic është i përkatësisë gorane. Unë me ty jam konsultuar edhe e ke ditë emrin që Fejsal Halilovic do të jetë i propozuar nga ana ime si nënkryetar. Ti ke shpreh rezervat tua, bile ke pas rezerva se a ta qesish në rend të ditës apo jo. Me dy partitë tjera unë jam konsultuar edhe e kam marrë miratimin që z.Fejsal unë ta propozoj si person i cili, nga komuniteti goran, që mund të jetë nënkryetar i komunitetit joshumicë. Unë edhe kjo Asamble e kemi zbatuar ligjin këtu. Unë e kam dhënë propozimin, komunitete joshumicë që përfaqësohen në Kuvend kanë votue, edhe Fejsal Halilovic e ka marrë miratimin - nga katër që jeni, tre prej tyre kanë votue pro. Edhe Asambleja me shumicë votash e ka zgjedhë. Tani Fejsal Halilovic, zyrtarisht edhe ligjërisht, është nënkryetar i komunitetit joshumicë për Komunën e Dragashit. Nuk ka shkelje të ligjit - ju mundeni me i ndjek procedurat ligjore, me bo ankesa, por përndryshe, edhe para katër viteve u veprua njëjtë, sikurse tash. Faleminderit!

Usmen Baldzi: Eshtë e vërtetë, u pajtova sepse nuk dua të kuptohet se jam kundër dikujt dhe që Kuvendi të funksionojë normalisht. Ju nuk biseduat fare me mua. Në Dragash kemi dy komunitete joshumicë, pra 2 me 2. UA për të cilin flisni ka kaluar; UA i ri nuk e parashikon, por thotë se fiton ai me numrin më të madh të votave. Në këtë rast, Fejsali kishte 3–1 dhe është legjitim. Propozimi juaj, pa mua, është i palegjitim dhe unë do t'i ankojem Ministrisë.

Artan Loshaj: Pasi pak më herët u diskutua për pronat e Komunës, unë drejtorin kam qef me e pyet - se tha, ka shpreh interesim për pronat edhe me i qit në uebfaqe të Komunës, se është ligjore - unë i kërkoj drejtorit që të jetë shumë transparent, që edhe lokalet të cilat i menaxhon Komuna le t'i bëjë publike, sa lokale i menaxhon Komuna, sa janë me qira, sa paguajnë qira edhe sa ka të lira, se ka qytetarë, për shembull që dëshiron ta marrë një lokal prej kuvendit komunal, edhe ta merr me një shumë pak më solide. Edhe due me i pyet kryetarin dhe drejtorin që, masi të dalin në

ankand publik këto lokale që i keni dhënë vitin e kaluar - kontratën unë e di që e bëjnë me kryetarin e Komunës, ose me drejtorin - lokalet të cilat dalin në ankand publik, që janë pronë komunale, edhe i fitojnë qytetarët me çmimin më të shtrenjtë, atë marrëveshje e bën me juve, apo me drejtorin? Me kryetarin. Unë me sa e di, për shembull, në qoftë se pronari, një muaj, dy apo tre muaj, nuk e bën pagesën, i ndërpritet kontrata. Në seancën e legjislaturës së parë, kryetar, drejtori na ka akuzue neve se kemi dhënë lokale, nuk kemi bo kontrata, i kemi lëshue pa pagesë. Tash po due me i thënë drejtorit, sa veta nuk i paguajnë, sa paguajnë, sa janë me qira? Me i bo transparente, masi po do para qytetarëve ky i mirë, në seancën tjetër me i pru këtu edhe me e pa në qoftë se nuk paguajnë ata, ka qytetarë të interesuar që do dikush me marrë ndonjë benefit prej Komunës, me qenë të privilegjuar, e dikush tjetër, jo veç të njëjtit persona. Kam qef edhe një herë, drejtor, shumë drejtpërdrejt, pres prej teje të jesh shumë i drejtpërdrejtë, se je superdrejtor, e di që duesh për të mirën e qytetarëve. Na biosh sa lokale i ka në menaxhim Kuvendi Komunal, edhe a ka të lira. Njëri prej tyre, për shembull, jam edhe unë, dua një lokal me e pas, të Komunës. A ka të lirë, po due me e ditë? Edhe, të shohim pagesat ku janë, se ka shumë qira aty që... ty të ka ardhë shumë lehtë kur kemi qenë në pushtet, të ka ardhë lehtë me i marrë qiratë. Ku je sot?

Qamil Kolloni: Delegat, je shumë i mirë, po veç po e harrojsh detyrën tënde. Ne si drejtori përgatitim këtë, komisionin e formon qeky Kuvend. Dhe, në bazë të rekomandimeve të Komisionit, kontratën e nënshkruan kryetari. Kemi dy lloje kontratash. Përmes ankandit publik dhe kontratat nën një vit për shfrytëzimin e pronës. E njëjta Rregullore për shfrytëzimin e lokaleve nën një vit është e nxjerrur nga qeky Kuvend. Të dy vendimet të cilat i ekzekuton drejtorati, janë dokumente të juaja. Unë do të jem në gjendje që t'ju bie, mirëpo të gjitha kontratat afatshkurtëra që janë, dalin për arsye se ne nuk mund ta dijmë pronarin tjetër se kush munden me e marrë. Të gjitha kontratat të cilave u skadon dhe duhet t'i nënshtrohen ankandit publik prapë i qesim këtu, për arsye se, mundet që gjatë daljes në ankand publik të ndërrojë pronari. Për atë arsye, këtu nuk dalin emrat e shfrytëzuesve të kontratave, por del vetëm Zona Kadastrale Dragash, numri i parcelës kaq, dhe metër katror kaq. Dhe ata të cilët janë të interesuar, në bazë të këtyre të dhënave munden me i gjet secilin lokal, në cilin vend dhe ku gjendet. Pra, këto janë shumë mirë të definuara. Për herën tjetër, mundesh me bo pyetje, të bina. Sot jemi për këtë listë, ta votoni apo mos ta votoni. E për herën tjetër, kemi kohë katër vite, kam me të dhënë raporte e raporte, sa të ke nevojë, brenda 24 orëve, se pikërisht për këtë çështje nuk kemi kurrëfarë problemi. është i vetm hap që në këtë

drejtori, pas 14 vjetëve kanë hy njerëzit, kanë kontrata. është punuar pa kontrata - së paku kanë kontrata, të kqëjja edhe të mira, mund të gjykos ti, mund të jenë edhe të këqija, por së paku kanë, nuk janë pa hiç. Kjo është ajo përparësia në raport me të kaluarën. Unë nuk deshta të diskutoj për borxhet këtu me hamendje, se nuk jam përgatit, për këtë është raporti financiar që jepet, i dalin të gjitha borxhet, sa kanë e sa s'kanë, kush ka e kush s'ka, i japim këtu, i raportojmë edhe nuk është problem.

Artan Loshaj: Me siguri kesh i qartë, drejtor. Unë nuk ta lypa për sot, se e di që ti ke ardhë pa përgatit. Unë të kërkova në seancën tjetër, pasi është viti 2026 - se tash jeni pak i lodhur, se jeni në zgjedhje prapë, kemi zgjedhje - të kuptoj - njëfarë relaksi e bëjsh për Vitin e Ri, mas Vitit të Ri të lypa. A ka lokale të lira? Unë s'po të them kush janë me qira - është mirë me qenë shumë transparent - unë një herë të lypa sa lokale i ka. Komuna e Dragashit sa lokale i menaxhon, Drejtoria e Financave? I menaxhon 52 - në rregull jemi. Sa janë me qira? Janë me qira 42, janë edhe 10 të lirë. Duhet me i bo publike qetu, se njerëzit nuk e dinë a ka të lira. Në qoftë se ka të lira, e bëjsh publike këtu. Janë kaç lokale të lira edhe i qesish në ankand këtu për qytetarët me i njoftue, se ky është vendi i kuvendarëve edhe i qytetarëve. Se secili qytetar bile nuk e di edhe në Komunë ku me hi e me të lyp ty. Këtu është vendi që i biesh ti, sikur këtë listën - tash qytetarët i dijnë këto parcelat, dikush është i interesuar edhe vjen i lyp në Urbanizëm, ose në drejtorinë e juaj. Unë lypa që edhe lokalet me i pru këtu në seancën tjetër, edhe masnej aty, kur t'i biesh ato, kemi debate aty. Por, në fillim unë po të kërkuj veç me i pru, numrin e lokaleve edhe sa janë të lira. Faleminderit!

Qamil Kolloni: Delegat, më fal se nuk e kam ditë që nuk e dish matematikën! Listat e veçantë që është, këto kregja janë të parapara me u dhënë në shfrytëzim. Kush paraqitet, janë të lira, janë 98. Kqyre, 171 i kemi si Komunë, pjesën tjetër e kemi të dhënë, të kontraktume. 98 janë pa kontraktue dhe gjatë vitit 2026 janë në dispozicion me u dhënë në shfrytëzim. Kqyri, numrat i ke, se nuk i ke lexue.

Artan Loshaj: z.Baldzi kur lyp i sqarim, këtu nuk po thotë numri i lokaleve, unë nuk e kam të qartë, se për qato është huti edhe mjegull ke bo - këtu po shkruan numri i parcelës, nuk po shkruan numri i lokaleve. Bon vaki në këtë numër të parcelës është edhe lokali, po ti është dashtë mirë me e sqarue këtë. Unë këtë e votova për, edhe është mirë me dhënë numrin e parcelave. Unë po të lyp i lokale, jo parcelë, drejtor, ti mirë e dijs çka jem t'u lyp unë. Qe katër vjet na e kemi bo këtë debat.

Numrin e lokaleve, ti parcelë më ke dhënë. Unë nuk e di që, për shembull, 865 është lokali, nuk e di unë, këtu po shkruan parcelë. Kur të na njoftosh edhe kur të na sqarosh shumë mirë ti, që këtu, te këto 98 të veçantat, numër 865, për shembull, 814, janë lokalet e Komunës, atëherë ne e bëjmë debatin ndryshe. Ti ke shkruar parcelë këtu, nuk ke shkruar lokal. Unë po të kërkoj - në eventuale jemi duke folë - numrin e lokaleve të cilat janë në pronë komunale. Sa janë të zëna ato, sa vetë ki marrin ato edhe sa janë të lira. Njëri prej tyre, prapë po të them, jam i interesuar unë një lokal të shtetit me e marrë. Me e pas, bon vaki privatniki më qet nesër, po due me e pas të shtetit, jam i interesuar. Shumë e thjeshtë është. Me e pru, sa kanë mbet, sa janë, ku janë, sa metër katrorë, edhe masnej e qesish në ankand publik, e masnej komisioni vendos. Unë t'i kam lyp lokalet, jo parcelat, se unë alfabetin e gjuhës shqipe e di, edhe matematikën e di, nashta edhe pse je ekonomist, ma mirë se ti.

Arijeta Skeraj: Sot është seanca e parë edhe është njëfarë si seancë solemne. Pasi që unë nuk kam pyetje, e as nuk kam ndonjë sugjerim për kryetarin, se veç e ka marrë besimin e krejt Komunës së Dragashit se qysh ka qeveris, bashkë me stafin e vet. është bërë një punë shumë e mirë edhe nuk ka nevojë as për pyetje, e as për sugjerim. Unë e mora fjalën që t'i uroj Resul Fetahut kryesuesin, i uroj që kjo pozitë të jetë për të shumë e mirë dhe të ketë suksese. Po ashtu, deshta t'i uroj edhe nënkryetarin Fejsal Halilovic. Derisa unë kam qenë kryesuese, kemi pas një bashkëpunim shumë të mirë, edhe me Fejsalin, edhe me Resulin. Zëvendëskryesuesit i uroj gjithë të mirat, edhe juve të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Kjo seancë është si seancë solemne, në seancat tjera duhet me fillue me pyetje edhe me përgjigje. Faleminderit!

Samidin Xheladini: Të nderuar delegatë, pyetje të keqe thuhet se nuk ka, përgjigjja munden mos me qenë e duhur, por unë deshta me thënë që pashë një vullnet të mirë - edhe qekjo është demokracia, që delegatët shumë me vend i kanë ngrit shqetësimet. Qeveria Komunale ka punuar vitin e kaluar me një staf thuajse të njëjtë - veç disa ndërrime të vendeve më duket po bëhen - dhe Qamili prapë është drejtor. Delegatët kanë të drejtë me pyet edhe me e ditë saktë, edhe opinionin - për hir të transparencës, se çmohet si komunë me transparente. Janë kërkesa të arsyeshme, të na biesh dhe të na japish me sqarime, se për shembull unë nuk marrë vesh në atë lëmi, na shpjegojsh neve edhe pak më në detaje, se ti në ekonomi je ekspert ama na nuk jemi shumë. Mu më pëlqeu që mënyrë permanente po kërkojnë që të bihet dhe ta dëshmojmë se jemi transparentë. S'ka pse me fsheh, nuk kemi diçka të fshehtë këtu, se në opinion dalim keq. Duhet ta biesh edhe të

dëshmohej që jemi transparentë edhe me e ditë çdo gjë çka është duke u dhënë. Ne nuk kemi diçka personale si delegatë, ose si parti, prandaj duhet të bihet këtu.

Usmen Baldzi: Nuk kam parë askund që të votohet pro dhe që propozuesi të ankohet. Drejtor, para jush është një njeri që dikur ka qenë drejtor për buxhet dhe financa; merreni parasysh. Ne nuk e dimë çfarë po japim, nuk i dimë numrat; kjo është bërë me ngut. Duhet që drejtorja e urbanizimit dhe punëtorët ta rregullojnë këtë, sepse po votojmë pro, nuk jemi kundër. Nuk di të shikoj në geoportal. Kryetari ka gabuar dhe mund të kërcejë deri nesër; ai më ka konsultuar për rendin e ditës, por nuk më ka pyetur nëse nga JGP-ja do të ishte Fejsal Haliloviqi. A e parashikon ligji të jetë nga komuniteti goran? Jo; kjo ka rënë. Nuk e keni parë UA-në. Tani është në bazë të numrit të votave. Nuk më keni konsultuar. Ju lutem që ekipi juaj i drejtorëve të jetë në vendin e vet; ata nuk mund të jenë mbi asnjë këshilltar të Kuvendit Komunal të Dragashit.

Xhyferie Bahtijari Beqiri: z.Kryesue, pas urimeve vijnë edhe përgjegjësitë. Do të kisha kërkuar nga ju që, para se të fillojmë me përgjegjësi më të mëdha të kryerjes së punëve më të mëdha dhe më të rëndësishme për qytetarët e Komunës sonë, kisha kërkuar disa përmirësime brenda sallës së Kuvendit Komunal, në mënyrë që të funksionojë pak më mirë dhe të kryhen seancat në mënyrë më të mirëfilltë. Nëse ka mundësi të fillojmë me mikrofonat, për secilin nga kuvendarët që t'i kemi nëpër ulëse, pastaj do të ishte mirë të vazhdojmë edhe me emrat, të vendosen përpara; pjesa e perdeve të cilat mungojnë në sallën e Kuvendit Komunal dhe, me sa po e shoh, shumica palltot i keni të veshur, mirëpo po na nevojitet edhe varëse për palltot e pjesëmarrësve. Ndoshta si femër që jam, i kam kushtue pak a shumë edhe një rëndësi të vogël pjesës së dukjes së Kuvendit Komunal dhe pres mirëkuptim nga ana juaj si kryesues. Faleminderit të gjithëve dhe, njëkohësisht, ju uroj një punë të mbarë të gjithë asambleistëve të cilët kanë fituar këtë mandat! Na priftë e mbara të gjithëve, për të mirë të qytetarëve të Dragashit! Faleminderit!

Resul Fetahu: Faleminderit! Do ta kemi në konsideratë këtë kërkesë.

Granit Rifaj: E mbështesim edhe propozimin e parafolësës, po unë e kam një propozim që ka qenë praktikë më herët. Kisha kërkuar prej jush, në qoftë se është e mundshme, materialet edhe në

formë fizike me u dorëzue, se ndonjëherë me këto mënyrat e digjitalizume nuk po mundemi me krye punë. Në qoftë se bën!

Resul Fetahu: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e mbyllim këtë seancë! Shihemi në seancat e tjera! Ju faleminderit!